



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr. 355/4 prot.

Tiranë, më 16.04.2026

**V E N D I M**

**PARALAJMËRIMI**

Nr. 34, datë 16.04.2026

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VLERËSIMIT TË LIGJSHMËRISË SË  
PROCESIT TË NDJEKUR PËR VLERËSIMIN E REZULTATEVE NË PUNË PËR  
NËPUNËSEN VALENTINA SKËNDERAJ, NË INSTITUCIONIN E AGJENCISË  
KOMBËTARE TË ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE  
KUALIFIKIMEVE, SI DHE PARALAJMËRIMIN E INSTITUCIONIT PËR TË  
RREGULLUAR LIGJSHMËRINË.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të veprimeve administrative të kryera gjatë zhvillimit të procedurës së vlerësimit të rezultateve në punë për 6-mujorin e dytë të vitit 2025, për nëpunësen Valentina Skënderaj,

**VËREJ SE:**

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është regjistruar informacioni me shkresën me nr. 355 prot., datë 23.02.2026, nëpërmjet të cilit nëpunësja Valentina Skënderaj, me detyrë “Specialist”, Sektori i Shërbimeve Mbështetëse dhe Projekteve, pranë Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, ngre pretendime për parregullsi të lejuara në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil në

procedurën e vlerësimit të rezultateve në punë, për periudhën e vlerësimit Korrik - Dhjetor 2025.

Konkretisht, në përmbajtje të informacionit dhe të dokumentacionit të administruar bashkëlidhur tij, nëpunësja pretendon se, procedura e vlerësimit dhe rivlerësimit të rezultateve në punë për periudhën Korrik-Dhjetor, viti 2025 është kryer në kundërshtim me kërkesat e ligjit, sa i takon: **a)** *mungesës së komenteve dhe argumentimit për mënyrën e vlerësimit dhe b)* *mosrespektimit të fazave të procesit të vlerësimit*, detyrime këto të përcaktuara në nenin 62, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, të ndryshuar.

Në këto kushte, nëpunësja ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për verifikimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve të krijuara nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjit me detyra specifike gjatë aplikimit të institutit të vlerësimit të rezultateve në punë.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11 dhe nenin 14, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pasi u njoh me pretendimet e parashtruara nga nëpunësja Valentina Skënderaj, filloi procesin e verifikimit të informacionit, nëpërmjet shkresës nr.355/1 prot., datë 03.03.2026, “Kërkesë për dokumentacion në lidhje me verifikimin e informacionit të administruar pranë Komisionerit nga nëpunësja Valentina Skënderaj”, duke vënë në dijeni institucionin për fillimin e verifikimit të kësaj procedure vlerësimi, si dhe duke kërkuar dokumentacionin në të cilin materializohet ajo.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, institucioni i Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve nëpërmjet shkresës nr. 110/1 prot., datë 09.03.2026, të Drejtorit të Përgjithëm “*Kthim përgjigje*”, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 355/2 prot., datë 11.03.2026, ka paraqitur sqarimet përkatëse për rastin konkret.

Nga analiza e materialeve të dërguara nga institucioni, rezulton se:

Nëpunësja V. Skënderaj me detyrë “*Specialist*”, Sektori i Shërbimeve Mbështetëse dhe Projekteve, pranë Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, në datën 14.01.2026 është njohur me formularin e vlerësimit të punës për periudhën 01.07.2025–31.12.2025. Zyrtarët e ngarkuar nga ligji për kryerjen e procesit të vlerësimit të rezultateve në punë, kanë plotësuar rubrikat përkatëse të ndarjeve të këtij formulari, duke e vlerësuar nëpunësen në nivelin 3, “**Kënaqshëm**”.

Nëpunësja V. Skënderaj duke mos qënë dakord me nivelin e vlerësimit, në mbështetje të pikës 1, të kreut V, të VKM-së nr. 109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në

*punë të nëpunësve civilë*”, i ndryshuar, ka kërkuar nga Zyrtari autorizues të shqyrtojë edhe një herë rezultatin e vlerësimit.

Pas shqyrtimit, Zyrtari autorizues e ka rivlerësuar nëpunësen, duke ruajtur të njëjtin nivel vlerësimi 3, **“Kënaqshëm”**.

Sa i takon procedurës së ndjekur gjatë procesit të vlerësimit të rezultateve në punë, sqarohet se, në bazë të nenit 62, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe pikës 2, të kreut II, të VKM-së nr. 109, datë 26.02.2014, *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”*, i ndryshuar, që ka dalë në zbatim të kësaj dispozite, vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësit civilë të konfirmuar, është një proces që duhet të realizohet çdo 6 muaj, brenda vitit kalendarik dhe duhet të respektohen të gjitha fazat e tij, ashtu si parashikohen në pikën 12, kreu II, i aktit nënligjor në fjalë, e konkretisht:

- Planifikimi, është momenti kur Zyrtari raportues, përcakton objektivat kryesorë të punës dhe sjelljet përkatëse profesionale që bëjnë të mundur realizimin e planit të punës, përmbushjen e objektivave dhe të misionit të institucionit. Në fazën e planifikimit përfshihet përgatitja e objektivave dhe e një plani veprimtarish për arritjen e objektivave kryesore. Objektivat kryesorë të punës duhet të jenë të matshëm, kurse veprimet të dukshme. Në këtë fazë Zyrtari raportues dhe nëpunësi që do të vlerësohet diskutojnë së bashku qëllimet e nëpunësit për karriere, aspiratat dhe çdo gjë tjetër që lidhet me trajnimin dhe zhvillimin profesional.
- Bisedimet e ndërmjetme, zhvillohen në mes të periudhës së vlerësimit, ku Zyrtari raportues takohet me secilin prej nëpunësve që do të vlerësohet për të rishikuar progresin e kryer në arritjen e objektivave të planifikuara për të shprehur mendime dhe për të dhënë komente, si dhe për të evidentuar përmirësimet e nevojshme në planin e hartuar me shkrim.
- Vlerësimi përfundimtar, është një proces që ka të bëjë me vlerësimin e përmbledhur të suksesit të nëpunësit që do të vlerësohet në arritjen e objektivave kryesore të punës, duke respektuar afatet e vlerësimit.

Konstatohet se, në rastin e vlerësimit të nëpunëses V. Skënderaj, nuk janë zhvilluar fazat e kërkuara gjatë procesit të vlerësimit, midis nëpunëses dhe Zyrtarit Raportues pasi nuk evidentohen shënime apo procesverbale ku të jenë materializuar të gjitha fazat e vlerësimit. Rezulton se, *“Formulari i Vlerësimit të Punës”*, është i vetmi dokument që përmban të dhëna në lidhje me vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunëses për periudhën Korrik-Dhjetor 2025.

Gjithashtu, konstatohet se, Zyrtari raportues **nuk ka plotësuar me komente** ndarjet C) dhe Ç), *“Komentet e Zyrtarit raportues/Shpjegime”*, në kundërshtim me kërkesat e pikës 7,

kreu IV, të Vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Në ndarjet C dhe Ç parashikohet mundësia e vlerësimit nga Zyrtari raportues së bashku me hapësirat përkatëse për komente dhe shpjegime të nëpunësit e të Zyrtarit raportues. Këto plotësohen edhe gjatë fazës së bisedimeve të ndërmjetme. Në fund të periudhës së vlerësimit, Zyrtari raportues bën vlerësimin e rezultateve individuale në punë”.

Referuar problematikës së evidentuar më sipër, sa i takon **mangësive** në plotësimin e formularit në rastin e vlerësimit të nëpunëses, njësia e burimeve njerëzore, duhet të kujdeset në vijim, që në momentin e dorëzimit të aktit të vlerësimit, të kontrollojë plotësimin e të gjithë elementeve të aktit dhe në rast se konstatohen parregullsi, ta kthejë atë për plotësim tek zyrtari vlerësues që i korrespondon problem që duhet rregulluar, i cili në përputhje me kërkesat e aktit nënligjor, që është Vendimi nr. 109, datë 26.02.2014, i Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, të materializojë qëndrimin e tij me komentet dhe argumentet përkatëse.

Më pas, formulari duhet t’i vihet në dispozicion nëpunësit të vlerësuar për t’u njohur me të, si dhe për ta nënshkruar atë, duke respektuar gjithashtu kërkesat ligjore sa i takon afateve të ankimit.

Për më tepër, parregullësi janë konstatuar edhe nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, e cila me vendimin nr. 80-2026-858, datë 02.03.2026, ka vendosur:

1. Pranimin e padisë së palës paditëse Valentina Nogu;
2. Shfuqizimin e formularit të punës së nëpunësit civil, Valentina Nogu për periudhën 1 Janar-10 Qershor 2024; Formularit të vlerësimit të punës së nëpunësit civil Valentina Nogu, për periudhën 11 Qershor-30 Qershor si dhe formularit të vlerësimit të punës së nëpunësit civil, Valentina Nogu, për periudhën 1 Korrik-31 Dhjetor 2024, të Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve.

Në këto rrethana, sjellim në vëmendje të gjithë aktorëve të përfshirë në procesin e vlerësimit të rezultateve në punë se, vlerësimi i rezultateve në punë është një proces i rëndësishëm, i cili i shërben verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuara në fillim të periudhës së vlerësimit, si dhe i aftësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave. Vlerësimi i performancës në punë ka pasoja të rëndësishme për një nëpunës civil dhe shërben për të marrë vendime objektive edhe në lidhje me periudhën e provës, ngritjen në detyrë, lirimin nga shërbimi civil, si dhe në përcaktimin e nevojave për trajnim dhe zhvillim profesional të nëpunësit civil.

Sa më sipër, gjatë hartimit të formularit të vlerësimit të punës, nuk janë respektuar kërkesat e ligjit dhe akteve nënligjore, e për pasojë akti që ka finalizuar procesin e vlerësimit të

punës, është një akt që ka dalë në kundërshtim me nenin 109, ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, e për këtë arsye duhet të anulohet dhe të përsëritet procesi nga zyrtarët vlerësues sipas nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative.

### **Për këtë arsye:**

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; të nenit 109, germa b) dhe nenit 114, pika 1 dhe 2, e ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; si dhe në mbështetje të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar,

### **VENDOSA:**

Të paralajmëroj institucionin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, për rregullimin e situatës së ligjshmërisë, në zbatim të kërkesave të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke vepruar në këtë mënyrë:

1. Procesi i vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën Korrik – Dhjetor 2025, për nëpunësen Valentina Skënderaj, të përsëritet nga zyrtarët e përfshirë në këtë proces, duke u kujdesur që të plotësohen të gjitha rubrikat e formularit të vlerësimit.
2. Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, pranë institucionit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, duhet të ndjekë ecurinë e procesit administrativ, për realizimin e veprimeve të mësipërme.
3. Për kryerjen e këtij veprimi administrativ, lihet afat **1 muaj**, nga marrja dijani për këtë vendim.
4. Me kalimin e këtij afati, institucioni i Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
5. Të njoftohet për këtë vendim institucioni i Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, Departamenti i Administratës Publike, si dhe kërkuesja Valentina Skënderaj.
6. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur

mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONERI**

**Lefterije Lleshi (Luzi)**